VENDIM
Nr.1066, datë 29.12.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS "GJOKAJ", NË BASHKINË E VORËS TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5/1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugës "Gjokaj", në bashkinë e Vorës, të qarkut të Tiranës.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Vorës.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqet, 103 (njëqind e tre) m^2, truall dhe 86 (tetëdhjetë e gjashtë) m^2, objekt, në masën e përgjithshme të shpronësimit, 1 946 401 (një milion e nëntëqind e dyzet e gjashtë mijë e katërqind e një) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Vorës planifikuar në buxhetin e saj.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet po nga bashkia e Vorës.
6. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Vorës, për realizimin e këtij projekti.
8. Regjistrimi i ri i pasurive, 103 (njëqind e tre) m^2, truall dhe 86 (tetëdhjetë e gjashtë) m^2, objekt, shpronësuar në favor të bashkisë së Vorës, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Vorës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR "RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS GJOKAJ", NË BASHKINË E VORËS, QARKU TIRANË

Nr.	**Emër, mbiemër**	**Sip. m^2 truall**	**Çmimi lekë/m^2**	**Vlera në lekë**	**Zona kadastrale**	**Nr. i pasurisë**
1	Jahe Liman Sipri	103	1258	129574	1751	3365/3/1
Nr.	**Emër mbiemër**	**Sip. m^2 objekt**	**Çmimi lekë/m^2**	**Vlera në lekë**	**Zona kadastrale**	**Nr. i pasurisë**
1	Jahe Liman Sipri	86	21 125.9	1 816 827	1751	3365/3/1
	Totali lekë			**1 946 401**		